

Fleta e të dhënave teknike

# MULTIFILL DIAMOND 1-12

## Stuko pllakash me performancë të lartë, me bazë çimentoje, i modifikuar me polimerë, ideale për dekorime

### Përshkrimi

MULTIFILL DIAMOND 1-12 është një stuko për pllaka me performancë të lartë, për dekorime, izolues i mire ndaj lagështirës, me ngjyra, e cila mund të përgatitet shpejt, i modifikuar me polimerë, me bazë çimentoje. Falë përbërjes së tij pa çimento Portland, ajo siguron një njëtrajtshmëri të përsosur të ngjyrave dhe parandalon shfaqjen e depozitave të kripës dhe të gëlqeres. Për të njëjtën arsye, ajo është gjithashtu edhe e lehtë për t'u përdorur dhe jo irrituese. MULTIFILL DIAMOND 1-12 zhvillon shumë shpejt, brenda 24 orëve, një fuqi të lartë mekanike. Karakteristika të tjera përfshijnë gjithashtu një rezistencë të shkëlqyeshme ndaj ujit që pikon nga lart. Agjentët e veçantë bakteriostatikë që ajo përmban, parandalojnë rritjen e baktereve në bashkimet (nyjet) e pllakave. Ideale për nyje me përmasa 1-12 mm. Klasifikuar sipas standarteve EN 13888 si stuko CG2 WA për pllaka.

### Fushat e aplikimit

Ideuar për shtresa të brendshme dhe të jashtme të dysHEMEVE dhe MUREVE, në të gjitha llojet e pllakave.

### Të dhëna teknike

Forma:	pluhur çimentoz
Ngjyra:	18
Kërkesa për ujë:	0.90-1.00 l/4 kg për thes
Dendësia e pjesës bazë të llaçit të thatë:	1.20 ± 0.05 kg/l
Dendësia e pjesës bazë të llaçit të freskët:	1.70 ± 0.05 kg/l
Temperatura e aplikimit:	nga +5°C në +35°C
Rezistencë ndaj gërryerjes:	≤ 250 mm <sup>3</sup> (EN 12808-2)
Forca ngjeshëse pas:	
• 28 ditësh:	25.00 N/mm <sup>2</sup>
• 25 ciklesh ngrirje-shkrirje:	25.00 N/mm <sup>2</sup> (EN 12808-3)

Forca e përkuljes pas:

- 28 ditësh: 7.00 N/mm<sup>2</sup>
- 25 ciklesh ngrirje-shkrirje: 7.00 N/mm<sup>2</sup> (EN 12808-3)

Tkurrja për shkak të tharjes: ≤ 1.00 mm/m (EN 12808-4)

Përthithja e ujit pas:

- 30 min: ≤ 0.10 g
- 240 min: ≤ 0.40 g (EN 12808-5)

Jetëgjatësia në kovë: të paktën 50' në +20°C

Qëndrueshmëria

e ecjes mbi tër: pas 3-4 orësh në +20°C

### Udhëzimet për përdorim

#### 1. Nënshtrësia

Nënshtrësia e mbuluar nga pllakat duhet të jetë krejtësisht e pastër. Nyjet duhet të pastrohen dhe lagen me një sfunjër të lagur.

#### 2. Aplikimi

MULTIFILL DIAMOND 1-12 shtohet në ujë duke e përzier vazhdimisht derisa të formohet një pastë e njëtrajtshme. Rekomandohet një mikser me shpejtësi rrotullimi të ulët për përzierjen. Përzierja duhet të lihet të qëndrojë ashtu për rreth 3 minuta dhe pastaj të trazohet përsëri nga pak.

Përhapeni stukon diagonalisht nëpër nyje duke përdorur një shpëhapës gome, në mënyrë që t'i mbushni ato plotësisht. Materiali i tepërt duhet të fshihet pas njëfarë kohe, duke përdorur një sfunjër të lagur, për të shmangur çdo ndryshim të ngjyrës. Në fund, sipërfaqja mund të pastrohet me një leckë të thatë.

Për përdorim në ambiente të jashtme ose në temperatura të larta, rekomandohet lagia e përsëritur pas disa orësh dhe kur stukoja të jetë tharë.

# MULTIFILL DIAMOND 1-12

## Konsumi

Konsumi i MULTIFILL DIAMOND 1-12 varet nga përmasat e pllakave si dhe gjerësia e nyjeve. Rastet e mëposhtme jepen thjesht si referencë (vlerat në g / m<sup>2</sup>):

Përmasat e pllakve (cm)	Gjerësia e nyjes			
	2mm	4mm	8mm	12mm
2 x 2 x 0.3	820	1.63	---	---
10 x 10 x 0.6	330	650	1.31	1.960
15 x 15 x 0.7	250	510	1.02	1.520
20 x 20 x 0.7	190	380	760	1.140
30 x 30 x 0.8	150	290	580	870
40 x 40 x 0.8	110	220	440	650
50 x 50 x 0.8	90	170	350	520

## Paketimi – Ngjyrat

MULTIFILL DIAMOND 1-12 është në dispozicion në 18 ngjyrat e mëposhtme së bashku me kodet korresponduese, në pako 4 kilogramëshe:

Ngjyra	
01 E bardhë	•
02 E zezë	•
03 Gri	•
05 Gri e lehtë	•
06 Bezhë	•
08 Kafe	•
09 Kafe e lehtë	•
10 Gri e errët	•
17 Anemone	•
20 Gështenjë	•
21 Karamel	•
29 Gri i argjendtë	•
30 Gri çimentoz	•
40 Kafe e errët	•
41 Kafe ngjyrë toke	•
42 Gri në të bezhë	•
45 Ngjyrë rëre	•
46 Gri në të blu	•

Grupe të mostrave realiste të MULTIFILL janë në dispozicion.

## Afati i ruajtjes – Kohëzgjatja

24 muaj nga data e prodhimit, në paketim origjinal, të pahapur, në vende të mbrojtura nga lagështia dhe ngricat.

## Shënime

- Konsultohuni përpara përdorimit me udhëzimet rreth sigurisë të shënuara në paketim.

## ISOMAT S.A.

INDUSTRI MATERIALESH NDERTIMI KIMIKE & LLAÇESH  
ZYRAT QENDRORE – FABRIKA:

Kilometri i 17<sup>te</sup> i Autostradës Selanik-Aj. Athanasiu  
570 03 Aj. Athanasios, Tel. : 2310 576 000, Fax: 2310 722 475  
[www.isomat.al](http://www.isomat.al) e-mail: [support@isomat.eu](mailto:support@isomat.eu)